



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

- Kuvendi Komunal
01 Nr.0619566/2
Dt.26.11.2015
D r a g a s h

Në bazë të nenit 12.2. shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës“ nr.28/2008), nenit 10, paragrafit 1, nëparagrafit 1.5 të Ligjit 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtëshme Komunave, si dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës- Dragash 01 Nr.06-103/1 të dt.11.09.2008, pas rishqyrtimit paraprak të Kërkesës së KEDS-it SHA 01 Nr.463-9089 të dt.12.06.2015 e konform Vendimit të KK-së Dragash 01 Nr.06-9420/2 të dt.30.06.2015 dhe shqyrtimit të Shkresës-Kërkesë të dy Ministrive (MAPL-së dhe MMPH-së, përkatësisht Raportit të Komisionit të këtyre ministrive), lidhur me dhënin e Pëlqimit për vendosjen e trafos së blinduar 630 kWA në fshatin Rapçë e Epërme, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.26.11.2015, miraton këtë:

V E N D I M
PËR VENDOSJEN E TRAFOS SË BLINDUAR 630 KWA

- I. **NDAHET** trolli, për interesa të përgjithshme shoqërore, në sipërfaqe prej 25 m/2 (pronë komunale), në ZK 1224 në ZK Rapçë e Epërme-Dragash, për vendosjen e trafos së blinduar 630 KWA.
- II. Për zbatimin e këtij Vendimi përkujdeset kryetari i Komunës dhe Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim, Katastër dhe Mbrojtje të Mjedisit-Dragash.
- III. Vendimi hynë në fuqi 15 ditë nga regjistrimi në protokolin e Zyrës së MAPL-së, si dhe publikimit në web-faqen e Komunës-Dragash.

I dërgohet:

- KEDS-it Prishtinë (Prizren-Dragash),
- MAPL-së (Zyrës Ligjore) - Prishtinë,
- Drejtoratit për Urbanizëm, Katastër dhe Mbrojtje të Mjedisit-Dragash, dhe
- Arkivit

Kryesesi i KK-së Dragash
Shaban Shabani,

